



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ORIKUM  
ZYRA E KRYETARIT

[www.oriikum.gov.al](http://www.oriikum.gov.al) Tel: 0391 22325; Fax: 0391 22325; [info@oriikum.gov.al](mailto:info@oriikum.gov.al)

Nr 2093 prot

Date 12/11/2014

KONTRATË  
MBI KRYERJEN E PUNIMEVE SHITESË  
PËR OBJEKTIN E PROKURIMIT  
“RIKONCEPTIMI I SHESHIT PARA BASHKISË ORIKUM

Ë lidhur sot më datë 12/11/2014 midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Oriikum, përfaqësuar nga Kryetari Z.Gëzim ÇAPOJ, dhe bashkimit të operatorëve ekonomik “Glavencia”shpk & “Vllaznia” shpk, përfaqësuar përkatësisht nga Z.Agim Baraj dhe Z.Ylber Kalaja

Neni I

Baza Ligjore

Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” I ndryshuar, neni 33 pika 5/a “Procedura me negociim pa shpallje paraprake”, si dhe VKM-së Nr.01 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Neni 33 pika 5/a, Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, mund të përdoret përkontratat e punëve dhe të shërbimeve:

a) për punë apo shërbime shtesë, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në kontratën fillestare, por që, për shkak të rrethanave të paparashikuara, janë bërë të domosdoshme, me kusht që t’i jepen operatorit ekonomik, që realizon këto ndërtime apo shërbime, si dhe kur vlera e punës dhe/ose shërbimeve shtesë nuk e tejkalon 20 për qind të vlerës së kontratës fillestare.



## Neni 2

### Objekti I kontratës

Objekti I kësaj kontrate është kryerja e punimeve shtesë, sipas preventivit bashkangjitur kësaj kontrate, të cilat nuk kanë qënë të parashikuara në kontratën kryesore, por që kanë lindur të domosdoshme për tu kryer gjatë zbatimit të kontratës kryesore nënshkruar më datë 08.07.2014, për objektin e prokurimit "Rikonceptimi I Sheshit para Bashkisë Orikum", financuar nga Fondi I Zhvillimit të Rajoneve.

## Neni 3

### Vlera e kontratës

Vlera e kësaj kontrate shtesë është e fiksuar<sup>2</sup> në vlerën dhe zërat e punimeve të përcaktuara në preventivin bashkangjitur kësaj kontrate shtesë:

1.577.280 ( një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë)lekë pa TVSH.

1.892.736 ( një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë ) lekë me TVSH

## Neni 4

### Sigurimi I kontratës


Sigurimi I kësaj kontrate shtesë fiksohet në vlerën 189.274( njëqind e tetëdhjetë e nëtë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

## Neni 5

### Afati I kontratës

Afati për përmbushjen e kësaj kontrate fiksohet në një afat 10 (dhjetë) ditë kalendarike, duke filluar nga momenti I nënshkrimit të kësaj kontrate.

<sup>2</sup> 20% e vlerës së kontratës kryesore e nënshkruar me një vlerë prej 9.463.680 lekë me TVSH



## Neni 6

### Dispozitat e fundit

Kjo kontratë bëhet pjesë integrale e kontratës kryesore të lidhur më datë 08.07.2014, duke ju nënshtruar të gjitha kushteve kontraktuale të përcaktuara në të.

Preventivi shtesë dhe projekti I ndryshuar, i bashkangjiten kësaj kontrate.

Kjo kontratë hartohet në tre kopje, një kopje I dorëzohet operatorit zbatues, një kopje mbikëqyrësit të punimeve dhe një kopje administrohet në dosjen e tenderit.

Kjo kontratë hynë në fuqi pas nënshkrimit nga palët, dhe dërgohet për botim në buletin e njoftimeve publike të Agjensisë së Prokurimit Publik, brenda 5 ditëve nga nënshkrimi I kontratës.

Autoriteti kontraktor

Bashkia Orikum


Gëzim CAPOJ



Bashkimi I operatorëve ekonomik

"Vllaznia" shpk & "Glavenica" shpk

Z.Ylber Kalaja dhe Z.Agim Baraj



"Glavenica" shpk pjesëmarrës me 56.7% dhe "Vllaznia" shpk pjesëmarrës me 43.3%





**POLICA E SIGURIMIT TË KONTRATËS**  
**GUARANTEE INSURANCE POLICY**

0002877

<b>Ref/ Ref No.</b>		<b>Data / Date</b>	
		12.11.2014	
<b>Per/To</b>			
BASHKIA ORIKUM , VLORE (Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor / Name and address of Contracting Authority)			
<b>Në emër të/ In the name of</b>			
GLAVENICA SHPK , BALLSH (Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar / Name and address of the insured bidder)			
<b>Procedurat e prokurimit (nëse zbatohet / Procurement procedures (if applicable))</b>		<b>E hapur /</b>	
(Referenca e dosjes nga Autoriteti Kontraktor / File reference according Contracting Authority)			
<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës/ Short description of the contract</b>		<b>RIKONCEPTIM I SHESHIT PARA BASHKISE ORIKUM (SHTESE KONTRATE)</b>	
(Lloji i procedurës dhe objekti / Type of procedure and object)			
<b>Publikimi (nëse zbatohet)/ Publication (if applicable)</b>		<b>Buletini i njoftimeve publike</b>	<b>Nr. / No</b>
			<b>Datë / Date</b>
<b>Duke ju referuar procedurës së lartpërmëndur, dhe me kusht që: Referring to the above procedure and provided that:</b>		<b>GLAVENICA SHPK</b>	
(Emri i ofertuesit të përcaktuar fitues / Name of the winning bidder)			
<b>ti jetë akorduar kontrata, ne vërtetojmë se: to be accorded the contract, we certify that:</b>		<b>GLAVENICA SHPK</b>	
(Emri i ofertuesit të përcaktuar fitues / Name of the winning bidder)			
<b>ka depozituar, pranë Shoqërisë së Sigurimit "ANSIG" sh.a. deposited in the name of "ANSIG" sh.a. Insurance Company</b>			
<b>Vlerën prej: Value of:</b>	<b>189,274.00 Lekë</b>	<b>NjëQindë e Tetëdhjetë e NëntëMijë e DyQindë e Shtatëdhjetë e Katër</b>	
(monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra / currency and value both in words and figures)			
<b>Si kusht për sigurimin e zbatimit të kontratës, që do të nënshkruhet me: As a condition for implementation of the contract signed with:</b>		<b>BASHKIA ORIKUM</b>	
(Emri i Autoritetit Kontraktor / Name of the Contracting Authority)			
<b>Marrim përsipër të transferojmë në llogari : We are liable to transfer at the account of:</b>		<b>BASHKIA ORIKUM</b>	
(Emri i Autoritetit Kontraktor / Name of the Contracting Authority)			
<b>Vlerën e siguruar, brënda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e kushteve të Kontratës. / The insured value within 15 (fifteen) days from your first written request, without requiring any explanation, in case of unfulfilled terms of the contract.</b>			
<b>Ky sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës / This insurance is valid up to the full implementation of the contract</b>			
<b>Nga Data / From</b>	<b>12.11.2014</b>	<b>Deri më / Up to</b>	<b>Deri në perfundimin e plote te kontrates</b>
<b>Lëshuar në / Issued to</b>	<b>Tirane</b>	<b>Data Lëshimit/ Issued Date</b>	<b>12.11.2014</b>

Jam dakort me kushtet e përgjithshme bashkëngjitur kësaj police/ I agree with the general conditions attached to this policy.

GLAVENICA SHPK

DEGA (Branch) AGJENTI (Agent)

Tiranë/Arta Goku

(emër, mbiemër, firmë, vulë)

